



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:008658

Datë: 09.02.2022

Numri i dokumentit: 02695105

PPP.nr.4/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit: KRK (Kreditimi Rural i Kosovës me nr te biznesit .. P. - Dega Istog, kundër debitorëve: M. A. me nr personal, me adresë në Fsh. Istog i poshtëm Rr. A. H. K-Istog (kredi marrës) dhe Sh. A. me nr personal, me adresë në Fsh. Istog i poshtëm Rr. A. H. K-Istog (kolateral dhënës), për shkak të borxhit në shumë prej 2,074.80 €, pas prapësimit të ushtruar nga ana e debitorëve me dt: 17.12.2021 kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit, gjykata jashtë seance me dt.09.02.2022 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorëve M. A. dhe Sh. A., qe te dy me adresë në Fsh. Istog i Poshtëm Rr. A. H. K-Istog ashtu që;

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi Lejimin e Përmbarimit P.nr.746/2021 të dt.03.12.2021, sa i përket sendeve te listuar në listën e kolateralit dhe atë Shpërndarës plehu e markës Blicher MS100, nr i Shasisë, Rotary Tiller me nr te shasisë, Traktor IMT-..... me nr te shasisë dhe Rimorkio IMT, pasi qe janë sende që shërbejnë për përmbarimin e nevojave elementare për te mbajtur veten dhe familjet e tyre dhe janë të përjashtuara nga përmbarimi konform nenit 85 par.1.3 e ne lidhje me par.2 te LPP-së.

III.OBLIGOHEN debitorët M. A. dhe Sh. A., qe te dy me adresë në Fsh. Istog i Poshtëm Rr. A. H. K-Istog, që kreditorit KRK (Kreditimi Rural i Kosovës me nr te biznesit, P. - Dega Istog, në emër të borxhit sipas marrëveshjes mbi kredi nr. KOBU-002912-001, t'ia paguajnë shumën e përgjithshme prej 2,074.80 €, të gjitha këto me kamat ligjore 8% nga data 03.12.2021 e deri në pagesën definitive te detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori KRK (Kreditimi Rural i Kosovës me nr te biznesit P. - Dega Istog, ka ushtruar propozimin për përmbarim te përmbaruesi privat, me të cilin ka kërkuar që të lejohet përmbarimi ndaj debitorëve M. A. me nr personal , me adresë në Fsh. Istog i Poshtëm Rr. A. H. K-Istog (kredi marrës) dhe Sh. A. me nr personal , me adresë në Fsh. Istog i Poshtëm Rr. A. H. K-Istog (kolateral dhënës), si në shkresat e lëndës me të cilën do të paguajnë borxhin në shumë prej 2,074.80 €, me kamat ligjore si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të urdhrin, në të kundërt të bëhet bllokimi i llogarive bankare, sekuestrohet kolaterali dhe ti dorëzohet kreditorit për shitje dhe nga mjetet e mbledhura të realizoj kërkesën e tij, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të dt. 03.12.2021.

Përmbaruesi privat me urdhrin përmbarimit P.nr.746/2021 të dt.03.12.2021, e ka lejuar propozimin për përmbarim në këtë çështje përmbarimore.

Debitorët M. A. me nr personal , me adresë në Fsh. Istog i Poshtëm Rr. A. H. K-Istog (kredi marrës) dhe Sh. A. me nr personal , me adresë në Fsh. Istog i Poshtëm Rr. A. H. K-Istog (kolateral dhënës), brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me shkrim kundër urdhrin përmbarimor me arsyetimin se nuk kanë pasuri që do të nënshtrohen përmbarimit meqenëse biznesi ka dështu, kështu që mundësit e pagesës së borxhit janë të kufizuara, përkundër kësaj, jemi të pajtimit që ta paguaj borxhin vetëm se të na mundësohet pagesa me këste, andaj propozojmë që të aprovohet prapësimi dhe procedura të pezullohet

Pas prapësimit të ngritur nga debitori, kreditori ka paraqitur përgjigjeje në prapësim duke kërkuar që urdhri përmbarimor të vërtetohet për shkak të borxhit në vlerë prej 2,074.80€, me arsyetimin se prapësimi i debitorëve është i pa bazuar dhe është bërë me qellim që të përfitoj kohë, pasi që debitorët nuk i janë përmbarimor skemës së kthimit të kredisë. Sendet të cilat janë lënë peng nuk janë sende që LPP-ja i përjashton prej përmbarimi, pasi që fillimisht i përjashton pajisjet bujqësore, mirëpo nuk vlen në rast të realizimit të kërkesave monetare të bankave në baze të huas specifike për qellim të zhvillimit të bujqësisë, respektivisht zanatit, andaj në marrëveshjen e kredisë, në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbarimore, kjo kredi është dhënë me qellim të blerjes së pajisjeve, me anë të së cilave do të ushtrohet zanati. Me tutje kreditori shton se disa herë i është tërhequr vërejtja debitorit përmes letër vërejtjeve dhe pasi që debitorët nuk i janë përgjigjur obligimeve kontraktuale, duke mos pasur alternativ tjetër kemi vazhduar çështjen në fjalë në procedurë përmbarimore.

Gjykata Themelore në Peje- Dega në Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorëve dhe thëniet e cekura në të njëjtin dhe gjeti se i njëjti është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorëve tregojnë pjesërisht shkaqet sikurse në

nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore, sipas të cilave do të pengohej përmbartimi i lejuar nga përmbartuesi privat.

Gjykata, pas shikimit të shkresave të lëndës, si dhe sa i përket pretendimeve të debitorëve kur thirren në atë se e kundërshtojmë urdhrin përmbartimor me arsyetimin se nuk kemi pasuri që do të nënshtrohen përmbartimit, të njëjtat pretendime gjykata persisht i aprovoj si të bazuara, pasi që dokumenti me të cilin është lejuar përmbartimi - Marrëveshja për kredi nr.KOBU-002912-001 e dt. se nënshkrimi 16.01.2019, ma konkretisht neni 13, e në lidhje me shtojcën-Anex 7.2 të marrëveshjes mbi kolateralin, konkretisht sendet e lëna kolateral dhe atë Shpërndarës plehu e markës Blicher MS100, nr i Shasisë . , Rotary Tiller me nr të shasisë ... , Traktor IMT-..... me nr të shasisë dhe Rimorkio IMT, duke u bazuar në nenin 85 të LPP-së i cili nën flet për sendet që janë të përjashtuar nga përmbartimi, ku në par.1.3 i po të njëjtit nën në mënyrë specifike përcakton sendet që përjashtohen prej përmbartimi dhe atë “ kafshët e punës dhe mbarështimit, pajisjet bujqësore dhe mjetet tjera, farërat, ushqimi për kafshë, mjetet, makinat dhe objektet tjera që i duhen debitorit, bujkut apo zanatliut për vazhdimin e punës në bujqësi, respektivisht në kryerjen e aktivitetit të zanatit, të nevojshme për të fituar të ardhurat minimale të nevojshme për të mbajtur veten dhe familjarët e tij”.

Po ashtu par.2 i të njëjtit nën parasheh se “Dispozitat nga nën par 1.3. par 1. i këtij neni nuk vlejnë për përmbartim të realizimit të kërkesave monetare të bankave, në bazë të huave specifike për qëllime të zhvillimit të bujqësisë, respektivisht zanatit, me kusht që ky qëllim është deklaruar në mënyrë të veçantë në kontratën për hua”, e në lidhje me nenin 71 të LPP-së i cili nën flet për bazën ku mund të mbështetet prapësimi, ku ndër të tjetra par.1.5 i LPP-së parasheh se “përmbartimi është caktuar për sendet të cilat janë të përjashtuara nga përmbartimi i detyrueshëm dhe, si rezultat i këtij përjashtimi, mundësit për kryerjen e përmbartimit janë të kufizuara”, andaj në rastin konkret duke u bazuar në dispozitat e lartcekura gjykata vlerëson se sendet e lëna kolateral, janë sende që janë të përjashtuar prej përmbartimi, konform dispozitave të lartcekura.

Nuk do të përjashtoheshin prej përmbartimi sendet e lëna kolateral vetëm nëse kredia do të merrej ekskluzivisht për zhvillim të bujqësisë, respektivisht të zhvillimit të zanatit në bujqësi, e në rastin konkret kredia është marr për blerjen e pajisjeve për ushtrimin e një zanati që nuk lidhet fare me bujqësinë, andaj vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktvendimi duke e aprovuar prapësimin e debitorëve pjesërisht si të bazuar dhe duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin mbi lejimin e përmbartimit sa i përket sendeve që janë të përjashtuara nga përmbartimit, pasi që urdhri i tillë për atë pjesë është i pa lejuar dhe i pa përshtatshëm për përmbartim.

Kurse sa i përket pretendimeve të debitorëve se mundësit e pagesës së borxhit janë të kufizuara, përkundër kësaj, jemi të pajtimit që ta paguaj borxhin vetëm të na mundësohet pagesa me këste, për të njëjtat pretendime kujtojmë faktin se me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes mbi kredi të dt. 16.01.2019, me të cilën marrëveshje kreditori i ka ofruar kredinë debitorëve në vlerë prej 4,000 €,

ne afat kthimit prej 30 muajve, ku ne nenet 4, 5 dhe 6 janë paraparë kushtet e kthimit te kredisë, sigurimi i te njëjtës dhe detyrimet e përgjithshme te kredi marrësit dhe kolateral dhënësit, kurse ne nenin 7 se njëjtës marrëveshje është paraparë qe ne rast mos përmbushjes se kredisë është parapa e drejta e kompensimit nga ana e debitorëve, andaj me rastin e shkeljes se neneve te kontratës, e cila kontratë është ligj për palët, janë shkaktuar pasoja juridike në dëm te kreditorit, andaj dhe kërkon shumën si në propozim për përbarim, e që debitorët janë të obliguar qe ta kthej këtë shumë si në pikën III te dispozitivit te këtij aktvendimi dhe atë duke u bazuar ne nenin 245 te LMD-së ku par.1 parasheh se “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak”.

Gjithashtu neni 249 par.1 te LMD-së parasheh se “Kreditori ka të drejtë në shpërblim të dëmit të thjeshtë dhe të fitimit të humbur, të cilat debitori është dashur t`i parashikonte detyrimisht në kohën e lidhjes së kontratës, si pasoja të mundshme të shkeljes së kontratës e duke marrë parasysh faktet të cilat i ka pasur të njohura ose është dashur detyrimisht t`i kishte të njohura”, ndërsa par.2 i po te njëjtit nen parasheh se “Në rast mashtrimi ose të mos përmbushjes me dashje, si dhe të mos përmbushjes për shkak të pakujdesisë së rëndë, kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitorët shpërblimin e të tërë dëmit, i cili është shkaktuar për shkak të shkeljes së kontratës, pa marrë parasysh atë se kreditori nuk ka ditur për rrethana të veçanta, për shkak të cilave janë shkaktuar ato”.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të propozimit (data 03.12.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, përshtatshëmish aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së.

Andaj nga arsyet e cekura më lartë, e konform dispozitave të nenit 3, 17, 22 par. 1.9, 36, 38, 69, 71 par.1.5, 73 par. 3 dhe 85 par.1 nen par 1.3 dhe par. 2 të Ligjit të Procedurës Përbarimore, e në lidhje me nenin 245 par.1 dhe 2, 249 par. 1 dhe 2, dhe neni 382 par. 1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e në lidhje me nenin 4, 5, 6, 7, dhe Anex 7.2 të Marrëveshjes mbi kredinë te dt. 16.01.2019, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.4/2022, dt.09.02.2022

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.